PA1.nr.308/2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët Gani Zabeli, kryetar, Afrim Shala dhe Shqipe Qerimi, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Bujar Ahmeti, si procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të akuzuarit Z.Z., nga fshati ..., Komuna e Dragashit, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor, nga neni 188 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4. i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas ankesës së të akuzuarit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Dega në Dragash, P.nr.185/2016, i datës 27 korrik 2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 15 maj 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të akuzuarit Z.Z., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, Dega në Dragash, P.nr.185/2016, i datës 27 korrik 2017, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren, Dega në Dragash, me aktgjykimin e lartcekur, të akuzuarin Z.Z., nga fshati ..., Komuna e Prizrenit, e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor, nga neni 188 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4. të KPRK dhe të njëjtin e ka dënuar me dënim me gjobë në shumë prej 150 € (njëqindepesëdhjetë Euro), të cilin dënim i akuzuari do ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e caktuar, i njëjti dënim me këtë aktgjykim zëvendësohet në dënim me burgim prej 5 (pesë) ditëve, duke llogaritur 20 € (njëzet Euro) për 1 (një) burgim.

I dëmtuari M.R., për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Është detyruar i akuzuari Z.Z., që të paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës penale sa ato të bëhen sipas llogarisë, kurse në emër të paushallit

gjyqësor të paguaj shumën prej 15 € (pesëmbëdhjetë Euro), si dhe për ekspertizë mjeko-ligjore shumën prej 20.44 € (njëzet Euro e katërdhjetekatër cent), të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë i akuzuari Z.Z., për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, duke i propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës, që ta aprovojë ankesën si të bazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, ashtu që i akuzuari të lirohet nga akuza.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtresën PPA/II.nr.317/2018, të datës 13 prill 2018, ka propozuar që ankesa e të akuzuarit, të refuzohet si e pabazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës, pasi mbajti seancën e kolegjit, shqyrtojë shkresat e lëndës, analizoi aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe ankesën e të akuzuarit Z.Z., konstatojë se:

- ankesa është e pabazuar.

Edhe pse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes së ligjit penal, megjithatë Gjykata e Apelit e Kosovës konform nenit 394 të KPP, të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtojë edhe në këtë drejtim dhe konstatojë se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përmban shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarit.

Sa i përket vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale në ankesën e të akuzuarit Z.Z., theksohet se gjykata i ka marrë për bazë vetëm dëshmitë e dëshmitarëve të cilët kanë dëshmuar në favor të të dëmtuarit, i cili është drejtor i shkollës dhe këta dëshmitarë këtë e kanë bërë për shkak të frikës se do të mbetën pa punë. Se dëshmia e dëshmitarit R.K., është kundërthënëse sa i përket fakteve vendimtare, kurse dëshmitarët të cilët nuk kanë marrë pjesë në seancë kanë deklaruar se drejtori ju ka ofruar deklaratat e gatshme, që të deklarojnë kundër të akuzuarit Z.Z.. Dëshmitarët Z.R. dhe H.I., kanë deklaruar se nuk kanë parë ndonjë sulm fizik e as lëndime tek i dëmtuari. Se i dëmtuari kishte shkuar vetë në Qendrën Familjare pa prezencën e zyrtarëve policor, ku tek i njëjti është konstatuar vetëm gërvishtje në anën e majtë të qafës. Nga provat e administruara nuk është vërtetuar se i akuzuari e ka sulmuar të dëmtuarin dhe se nuk është vërtetuar se i njëjti i ka shkaktuar lëndime trupore të dëmtuarit. Gjykata e shkallës së parë është dashur që ta ketë parasysh nenin 3 paragrafi 2 të KPP dhe ta marrë për bazë edhe deklarimin e të akuzuarit, i cili ka qenë i provokuar nga vetë i dëmtuari.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, pretendimet e lartcekura të paraqitura në ankesën e të akuzuarit Z.Z. për vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkelje të dispozitave të procedurës penale janë të pabazuara. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave në shqyrtim

gjyqësor e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike. Në këtë çështje penale, gjykata e shkallës së parë ka administruar një sërë provash, siç janë : marrjen në pyetje të të dëmtuarit M.R., dëgjimin e dëshmitarëve N.H., R.K., Z.R. dhe A.Z., marrjen në pyetje të të akuzuarit Z.Z., si dhe disa prova materiale, siç janë : raportet e oficerëve policor, foto dokumentacioni, mendimi i ekspertit mjeko-ligjor Dr.D.H. dhe raportin mjekësor nga Qendra e Mjekësisë Familjare. Pas vlerësimit dhe analizimit të të gjitha këtyre provave, gjykata e shkallës së parë e ka shpallur fajtor të akuzuarin Z.Z., ngase, veprimet e tij formojnë të gjitha elementet e veprës penale të lëndimit të lehtë trupor, nga neni 188 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4. të KPRK, kështu, që në këtë drejtim, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, edhe gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, andaj, edhe pretendimet ankimore të të akuzuarit janë të pabazuara. Kjo për faktin se është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, kështu që nuk mund të vjen në shprehje zbatimi i parimit *"in dubio pro reo"*, ngase nuk ka asnjë mëdyshje lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen. Është e vërtetë që dëshmitarët Z.R. dhe A.Z., kanë deklaruar se kanë vërejtur një mosmarrëveshje në mes të të akuzuarit dhe të dëmtuarit, mirëpo nuk kanë vërejtur se janë rrahur dhe nuk kanë parë lëndime tek i dëmtuari, mirëpo këto fakte janë vërtetuar nga dëshmitë e dëmtuarit, dëshmitarëve tjerë dhe nga provat materiale. Në anën tjetër, edhe pse në ankesën e të akuzuarit Z.Z., nuk specifikohen konkretisht se në çka konsistojnë shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë, Gjykata e Apelit e Kosovës, konstatojë se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij.

Meqë i akuzuari Z.Z., ka paraqitur ankesë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë gjendjes faktike, mirëpo, nuk ka paraqitur ankesë për shkak të vendimit për dënimin, atëherë, duke u bazuar në nenin 396 të KPP, kjo ankesë përfshin edhe ankesën kundër vendimit për dënimin. Andaj, duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore dhe faktin se është paraqitur ankesë në dobi të të akuzuarit për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, mirëpo nuk është paraqitur ankesë për shkak të vendimit mbi dënimin, atëherë Gjykata e Apelit e Kosovës, aktgjykimin e ankimuar sipas detyrës zyrtare e shqyrtojë edhe sa i përket vendimit për dënimin.

Lidhur me vendimin për dënimin, Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerëson se duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat të cilat i ka konstatuar edhe gjykata e shkallës së parë, dënimi i shqiptuar me gjobë ndaj të akuzuarit Z.Z. është në harmoni me peshën e veprës penale, intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit i parashikuar me nenin 41 të KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale; të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Meqë ndaj aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është paraqitur ankesë vetëm në dobi të të akuzuarit, atëherë, Gjykata e Apelit e Kosovës, duke u bazuar në nenin 395 të KPP (parimi *"Reformatio in Peius"*), nuk e ka bërë ndryshimin e aktgjykimit të ankimuar sa i përket vendimit për dënimin, përkatësisht llogaritjes së ditëve të dënimit me burgim nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin, për shkak se një gjë e tillë do të shkonte në dëm të të akuzuarit. Kjo për faktin, siç është cekur edhe më parë, në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, është vendosur se nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë në shumë prej 150 € (njëqindepesëdhjetë Euro) në afatin e caktuar, atëherë, dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim prej 5 (pesë) ditëve, duke llogaritur 20 € (njëzetë Euro) për 1 (një) ditë burgim. Një llogaritje e tillë është jo e saktë, mirëpo, është në dobi të të akuzuarit Z.Z., ngase, nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e caktuar, atëherë ai do t'i mbajë vetëm 5 (pesë) ditë burgim.

Duke u bazuar në këto që u tha më lartë e në bazë të nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti i Përgjithshëm
PA1.nr.308/2018, Më 15 maj 2018

Procesmbajtësi,	Anëtarët e kolegjit:	Kryetari i kolegjit,
Bujar Ahmeti	Afrim Shala	Gani Zabeli
	Shqipe Qerimi	